nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

### **O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për

realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- 
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike (Festivali i Peshkut)</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.	Ekipi menaxhues i eventit	1 ekip			
2.	Video TVC video promovuese per TV (30-60 sec)	1 video			
3.	Prodhimi i videove promovuese perpara eventit 3 (tre) video (15-60 sec)	2 sete			
4.	Mbulim dhe realizim i videove gjate diteve te eventit <i>(Ekip me kamera, dron dhe montazhier per realizimin e klipeve gjate diteve te eventit. 4 video reels (15-60 sec)</i>	1 set			
5.	Rrjeti social	1 shërbim			
6.	Materiale promovuese "Ftesë e vendosur ne shishe me tape	300 cope			

	druri dizajn dhe prodhim”				
7.	Materiale promovuese “Broshure promovuese dizajn dhe prodhim”	4000 copë			
8.	Materiale promovuese “T-shirt ,e branduar me motive te festivalit dizajn dhe prodhim”	70 cope			
9.	Materiale promovuese “Kapele e branduar me motive te festivalit dizajn dhe prodhim”	70 cope			
10.	Materiale promovuese “Çanta tekstili branduar me motive te festivalit dizajn dhe prodhim”	70 cope			
11.	Materiale promovuese “Flamur Plazhi i printuar ne tekstil dizajn dhe prodhim me përmasa 100X300 cm”	20 cope			
12.	Flamuj të printuar përgjatë zonës së festivalit	20 cope			
13.	Banner me Programin Struktura (Lightbox me ndricim led 400x300 cm)	1 copë			
14.	Postera promocionalw për shpërndarje në bizneset e zonës, lokale, hotele	100 cope			
15.	Personalizim i standave të gatimit	10 copë			
16.	Organizimi i kursit te gatimit (Masterclass)	1 shërbim			
17.	Tavoline sociale per cdo dite te festivalit	3 ditë			
18.	Programi artistik	1shërbim			
19.	Krijimi i Muzeut të peshkimit	1 shërbim			
20.	Aktivitete për fëmijë	1 shërbim			
21.	Mbulim me shërbim fotografik gjatë eventit	1 set			
22.	Mbulim me shërbim PR	1 shërbim			
23.	Struktura hyrëse e eventit	1 copë			
24.	Skenografia	1 shërbim			
25.	Shërbime elektrike dhe instalime për eventin	1 shërbim			
26.	Skëna e Festivalit	1 skenë			
				<b>Çmimi total</b>	_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH (eventi I)</b>					

Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike (Solar Music Festival)	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Ekipi menaxhues i eventit	1 ekip			
2.	Banner me programin <i>Strukturë lightbox me ndricim led 400X300 cm</i>	1 copë			
3.	Materiale promovuese “Flamur Plazhi i printuar ne tekstil dizajn dhe prodhim 100X300 cm”	20 cope			
4.	Prodhimi i videove promovuese perpara eventit 3 video promovuese reels para eventit (15–60 sec)	1 set			
5.	Paket brandimi me elementet grafik në format të hapur	1 shërbim			
6.	Mbulim dhe realizim i videove gjate diteve te eventit <i>(Ekip me kamera, dron dhe montazhier per realizimin e klipeve gjate diteve te eventit 4 video reels (15–60 sec)</i>	4 video			
7.	Mbulim me shërbim fotografik gjatë eventit	1 set			
8.	Rrjeti social	1shërbim			
9.	Mbulim me shërbim PR	1 shërbim			
10.	Skenografia	1 shërbim			
14.	Transport i artistëve të huaj Tiranë-Sarandë-Tiranë	1 shërbim			
15.	Backstage	3 dite			
16.	Barriera	40 copë			
17.	Rrjeta metalike	60 copë			
				<b>Çmimi total</b>	_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH (eventi II)</b>					
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike (Arena e	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	

<b>Sarandës)</b>					
1.	Ekipi menaxhues i eventit	1 ekip			
2.	Shërbim sigurie (roje sigurie 24 ore)	30 ditë			
3.	Kamera sigurie CCTV	8 kamera			
4.	Brandi i eventit	1 shërbim			
5.	Rrjetet sociale	1 shërbim			
6.	Postera (A2)	25 cope			
7.	Baner	30 m <sup>2</sup>			
8.	Broshura programi	1000 copë			
9.	Shërbime elektrike dhe instalime elektrike	1 shërbim			
10.	Dekorim me vargje dritash me llampa	200 ml			
11.	Jastëkë të mëdhenj për ulje (beanbags)	20 copë			
12.	Set tavolina birre	40 sete			
13.	Skena e Festivalit	1 skenë			
<b>Çmimi total</b>					_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH (eventi III)</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike (Tregu i krishtlindjeve në Sarandë)</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.	Ekipi menaxhues i eventit	1 ekip			
2.	Brandimi i hapësirës së marketit	1 shërbim			
3.	Rrjetet sociale	1 shërbim			
4.	Postera (A2)	50 cope			
5.	Baner	40 m <sup>2</sup>			
6.	TV Spot video promovuese 1-3 min	1 video			
7.	Gift Box	40 cope			
8.	Materiale promovuese	1000 cope			

	“Broshura programi dizajn dhe prodhim”				
9.	Mbulimi me shërbim fotografie	4 dite			
10.	Shërbim sigurie (roje sigurie 24 ore)	24 ditë			
11.	Kamera sigurie CCTV	8 kamera			
12.	Shërbime elektrike dhe instalime elektrike	1 shërbim			
13.	Dekorim i kioskave	17 cope			
14.	Struktura hyrëse e eventit	1 cope			
15.	F.V Dekorime Festive të shpërndara në treg	50 copë			
16.	Instalacione tematike për foto	4 copë			
17.	Programi artistik	1 shërbim			
18.	Mbulim me shërbim PR	1 shërbim			
19.	Skena e festivalit	1 skene			
<b>Çmimi Neto pa TVSH (eventi IV)</b>					
<b>Totali pa tvsh (Eventi I+II+III+IV)</b>					
<b>TVSH 20%</b>					
<b>Totali me tvsh (Eventi I+II+III+IV)</b>					

---

**Shtojca 3.**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

---


## **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

**Shtojca 5.**

*(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ..... është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### Objektivi kryesor:

Realizimi i eventit: **FESTIVALI I PESHKUT NË SARANDË**

#### **I. Përshkrimi sasior i shërbimeve që kërkohen për eventin “Festivali i Peshkut në Sarandë”:**

##### **1. Do të ketë një ekip menaxhues për organizimin dhe realizimin e eventit me përberje si më poshtë:**

- 1 (një) Menaxher i eventit
- 1 (një) Drejtor artistik
- 1 (një) Teknik Audio
- 1 (një) Teknik Video
- 1 (një) Grafik- dizajner
- 1 (një) Specialist Marketingu
- 1 (një) Përgjegjës shërbimi,
- 1 (një) Punonjës Koordinator logjistike
- 6 (gjashtë) Teknik podiumi ose skene
- 1 (një) teknik ndricimi

#### **Grafik-Dizajner**

Grafik-dizajneri do të jetë përgjegjës për konceptimin dhe realizimin e të gjitha materialeve vizuale në kuadër të eventit, duke siguruar përputhshmëri me identitetin e markës dhe cilësi të lartë estetike.

#### **Teknik Audio**

Personel teknik i kualifikuar për instalim, konfigurim, operim dhe monitorim të sistemeve audio profesionale gjatë eventit.

#### **Teknik Video**

Personel teknik i kualifikuar për instalim, konfigurim, operim dhe monitorim të sistemeve video, projektionit, mediaserverit dhe ekraneve LED.

#### **Teknik Ndriçimi**

Personel teknik i kualifikuar për instalim, programim dhe operim të sistemeve të ndriçimit profesional dhe pajisjeve efektive.

#### **Teknik podiumi ose skene**

Personel teknik i kualifikuar për montim, kontroll dhe menaxhim të strukturave skenike, podiumeve dhe elementëve përkatës.

Operatori ekonomik do të marrë përsipër të gjitha kostot e mbulimit të këtij shërbimi përfshirë kostot e ushqimit, akomodimit dhe transportit

##### **2. Realizimi i 1 (një) video promovuese (TVC) për eventin, e cila do të njoftojë datat dhe do të ftojë njerëzit të marrin pjesë**

Formati: MP4 ose MOV

- Rezolucioni: 4K UHD (3840 × 2160)
- Standardi i transmetimit: Në përputhje me standardet e transmetimit televiziv (raporti i pamjes 16:9)
- Audio: Stereo, 48 kHz
- Kohëzgjatja: 30–60 sekonda

#### **Cilësia e zërit**

- Regjistrim i pastër dhe profesional, pa zhurma të jashtme
- Voice-over (regjistrim audio jashtë kamere) me cilësi 96–320 kbps, në format E AV ose MP3

---

### **Teksti dhe grafika**

- Teksti në video të shoqërohet me titra (subtitles)
- Përfshirja e informacionit kryesor në gjuhën shqipe dhe, sipas nevojës, edhe në anglisht

### **Regjistrimi në terren**

- Vendndodhja: Bulevardi i Sarandës
- Vendet e xhirimit përcaktohen nga Bashkia Sarandë

### **Ekipi i produksionit**

- Ekip profesionist me përvojë në realizimin e materialeve video

### **Procesi i prodhimit**

- Planifikimi:

Hartimi i skenarit, tekstit dhe planit të xhirimeve, duke përfshirë intervista me përfaqësues të Bashkisë Sarandë dhe përfaqësues të subjektit realizues

- Regjistrimi:

Zhvillimi i xhirimeve sipas planit të miratuar

- Post-produksioni:

Montazhi i materialeve të realizuara, përmirësimi i cilësisë së zërit dhe imazhit, si dhe integrimi i elementeve grafike

## **3. Prodhimi i Videove promovuese (para eventit)**

Krijimi i 3 videove të animuara, të cilat do të përmbajnë:

- **Countdowns** për festivalin,
- **Artistët pjesëmarrës** dhe aktivitetet kryesore,
- **Sponsorët** e festivalit.

- Formati: MP4 ose MOV
- Rezolucioni: Minimumi 3840 × 2160 (4K UHD)
- Shpejtësia e kuadrove: 24–60 fps
- Raporti i aspektit: 16:9 dhe 9:16
- Kodi i kompresimit: H.264 ose H.265
- Audio: 48 kHz, 16-bit, format WAV ose MP3 (96–320 kbps)
- Dorëzimi: 3 video të shkurtra promovionale (15–60 sekonda), në 2 sete

## **4. Mbulim i shërbimit me video gjatë eventit**

### **Video Prezantuese për çdo ditë të festivalit**

**Qëllimi:** Të përmbledhë atmosferën dhe eventet kryesore të ditës

Xhirim: Kamera profesionale + dron (4K)

Formati: MP4 / MOV

Rezolucioni: 4K UHD

Stabilizim: Gimbal / stabilizim me dron

Output: 4 video të shkurtra (reels) me kohëzgjatje 15–60 sekonda + material arkiv (footage), 1 set.

Cilësia e Zërit:

Regjistrimi duhet të jetë i pastër dhe profesional, pa zhurma të jashtme.

Voice Over për videot.(regjistrim audio jashte kameres) me cilësi audio 96-320 kbps, në format ËAV ose mp3.

- **Teksti dhe Grafika:**  
Teksti i shkruar duhet të jetë i pranishëm si subtitle dhe të përfshijë informacionin kyç në shqip dhe në anglisht, kur është e nevojshme.
- **Regjistrimi në Terren**  
Vendet e xhirimit: Bulevardi kryesor Sarande  
Vendet e xhirimit do të përcaktohen nga Bashkia Sarande.  
Ekipi i Produksionit: Një ekip profesionist me përvojë në regjistrimin e videos.

Proçesi i Prodhimit

---

Planifikimi:

Hartimi i skenarit dhe planit të xhirimeve, dhe teksti do të hartohet nga Kontraktori me miratim të Bashkisë Sarandë.

Regjistrimi:

Realizimi i xhirimeve sipas planit të miratuar.

Post-Produksioni:

Redaktimi i materialeve të xhiruara, përfshirë përmirësimin e cilësisë së zërit dhe imazhit, si dhe integrimin e grafikëve

## 5. Rrjeti social:

Menaxhimi i komunikimit në rrjetet sociale për për eventin. Kjo përfshin një strategji me **20-30 postime** për të rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin për festivalin.

**Detajet e projektit:**

- **Strategji komunikimi ne Social media**  
**Lloji i përmbajtjes:** Postime organike dhe sponsorizuara
- **Formati:** Dizajne statike, video të shkurtra, storie interaktive
- **Përfshirja:** Countdoë ns, intervista me artistët dhe sponsorët, highlights të eventit
- **Platforma:** Instagram, Facebook, (opsionale)
- **Frekuenca:** Para, gjatë dhe pas eventit

## 6. Materiale promovuese dizajn dhe prodhim:

### a) Ftesë e vendosur në shishe

Ftesë e vendosur në shishe qelqi me tape druri, me dizajn të veçantë dhe material druri

Letër: 300 gr/m<sup>2</sup> matte / textured

Printim: Digital offset

Shishe: Qelq transparent + tapë druri

Dimension ftesë: 15x10 cm

Sasia :300 cope

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

### b) Broshura Programi (A4 e palosshme)

Broshurë e printuar në letër 170g/m<sup>2</sup>, me lluster, informacion për programin e festivalit dhe aktivitetet.

Permasa: A4

Printim: Offset

Rezolucion grafik: 300 dpi

Format: A4 palosje (bi-fold / tri-fold)

**Sasia:** 4000 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

### c) T-shirt e branduar me motive të festivalit

T-shirt 100% pambuk, me ngjyra dhe dizajn të personalizuar për festivalin, 180–200 gr/m<sup>2</sup>, print silkscreen / DTF. Me 4 ngjyra

**Sasia:** 70 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

### d) Kapele e branduar me motive të festivalit

Kapelet janë 100% pambuk me logon dhe motivet e festivalit, të dizajnuara për një përdorim të gjatë.

**Sasia:** 70 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

### e) Çanta tekstili me motive të festivalit

Çanta tekstili 100% pambuk, 220g/m<sup>2</sup>, të printuara me motive dhe logo të festivalit për përdorim praktik dhe promocional. Me 4 ngjyra printim dy ane

**Sasia:** 70 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

### f) Flamur plazhi (strukturë hekuri + bazament hekuri dhe flamur tekstil)

---

Flamur i printuar në tekstil me strukturë hekuri dhe bazament për përdorim në hapësira të jashtme.

**Sasia:** 20 copë

Permasa: 100 x 300 cm

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

**g) Flamur plazhi përgjatë zonës së festivalit**

Flamur plazhi i printuar me strukturë tub alumini + fiksime në shtyllë.

Material: Polyester flag fabric 110–130 gr

Printim: Sublimation print (dy anë)

Strukturë: Tub alumini + fiksime në shtyllë

Rezistencë: UV resistant

Permasa: 100 x 200 cm

**Sasia:** 20 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

**7. Banner me programin (Lightbox)**

Strukturë: Aluminium frame + LED backlight

Printim: Backlit film 200–250 micron

Rezolucion grafik: min 150 dpi në madhësi reale

Ndriçim: LED 6500K (ë hite neutral)

Përmasa: 400x300 cm

Sasia: 1 copë

Shërbimi: Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

**8. Postera promocional**

Letër: 200 gr/m<sup>2</sup>

Printim: Offset / digital

Rezolucion grafik: 300 dpi

Format: A2

Sasia 100 cope

Shërbimi: Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

**9. Personalizimi i 10 stendave të gatimit përfshirë sa më poshtë:**

**a) Baner Print veshje 22x1,5 për secilën stendë**

**Sasia:** 400 m<sup>2</sup> total

**Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

**b) Sinjalistike Forex Restoranti**

**Sasia:** 10 copë

**Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

**c) Menu e çdo stende në Pexiglas + UV**

Permasa: A3

**Sasia:** 10 copë

**Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

**d) Uniforma për çdo stendë të shefave (kapele, T-shirt, Përparëse)**

**Sasia:** 30 komplete

**Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

**e) Shtrojë letre 150 gr full print me motive të Festivalit**

**Sasia:** 5000 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

**f) Gota 12 oz eco letre me logo të festivalit**

**Sasia:** 10,000 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

**g) Pjata eco letre me logo të festivalit**

**Sasia:** 10,000 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

**h) Set druri bamboo (thik, lugë, pirun)**

**Sasia:** 5000 copë

---

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

i) **Kupa e kompeticionit të shefave**

**Sasia:** 1 copë

**Shërbimi:** Dizajnim, prodhim

j) **Medalje e kompeticionit të shefave**

**Sasia:** 30 copë

**Shërbimi:** Dizajn dhe prodhim në sasinë e kërkuar

Cdo element grafik para prodhimit duhet të aprovohet nga Bashkia Sarandë .

**11. Organizim i kursit të gatimit (Masterclass)**

Shfaqje live në ekran LED te skenes direkt nga stenda.

Moderator shef i talentuar i njohur kombtarisht me recetën, ushqimet dhe makineritë e nevojshme.

Video prezantim për arkiv dhe ë eb.

**Shërbimi:** Organizim dhe realizim

**12. Tavoline sociale për çdo ditë të festivalit për 3 (tre) ditë**

Skicë dhe planvendosje 2D dhe 3D për tavolinat dhe karriget e përdorura në festival.

**Sasia:** 200 m linear me tavolina druri mesatarish 180 cm (rreth 120 copë)

**Ulese:** 300 karrige cilësore druri.

**Dekor:** 300 m linear me dekor dhe ndriçim me llampa amerikane të dekoruara me lule.

Lloji: String lights (Edison bulbs)

Gjatësia: 300 m linear

Temperatura: 2700K (ë arm light)

IP rating: IP44/IP65

**13. Programi Artistik në Festivalin e Peshkut**

Krijimi dhe menaxhimi i programit artistik për çdo natë të festivalit, me 3 të ftuar kryesorë:

a) **Këngëtar ose bandë/grup në hapje për secilën natë të festivalit**

- Këngëtar ose bandë/grup me ndikim dhe njohje kombëtare për të hapur çdo natë të festivalit.

b) **Këngëtar, grup ose DJ kryesor për secilën natë të festivalit**

- Këngëtar, grup ose DJ kryesor i famshëm me ndikim të lartë, për të kryer performancën e natës.

c) **DJ për mbylljen e natës për secilën natë të festivalit**

- DJ i njohur kombëtarisht për të mbyllur natën me performancën finale.

d) **Menaxher skene**

- Menaxhimi dhe organizimi i aktivitetit të skenës nga një menaxher profesionist për të siguruar rregull dhe sukses të shfaqjeve.

Operatori ekonomik do të marrë përsipër të gjitha kostot e mbulimit të këtij shërbimi përfshirë kostot e ushqimit, akomodimit dhe transportit

**14. Krijimi i Muzeut të peshkimit**

Për krijimin dhe menaxhimin e Muzeut të Peshkimit, kërkohen shërbime dhe materiale të ndryshme:

**1. Kurator Artistik**

- Krijimi dhe menaxhimi i kuratorit artistik për ekspozitat dhe përmbajtjen vizuale të muzeut.

**2. Menaxher Prodhimi**

- Menaxhimi i prodhimit dhe realizimit të ekspozitës së muzeut, duke siguruar koordinimin e shërbimeve dhe materialeve.

**3. Telajo Druri me Kanavac Tekstil (130x400)**

- Dizajnim, prodhim dhe montim i telajove druri me kanavac tekstil për vendosjen e pikturave dhe informacionit.
- **Përmasat:** 130x400 cm
- **Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

**4. Telajo Druri me Kanavac Tekstil (130x200)**

- **Përmasat:** 130x200 cm
- **Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

## 5. Telajo Druri me Kanavac Tekstil (130x600)

- **Përmasat:** 130x600 cm
- **Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

## 6. Banner i Printuar me telajo me Grafikë Informatore rreth Peshkimit të Qytetit nder vite

- Banner informues për historinë dhe evolucionin e peshkimit në qytet gjatë viteve.  
Përmasat: 130: 700 cm
- **Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

## 7. Foto të Printuara te peshkatave te qytetit në Forex dhe të Varura me Fillospanje Transparente

- Foto të printuara në material forex dhe të varura me fillospanje transparente në lartësi të ndryshme.
- **Përmasat:** 50x30 cm
- **Sasia:** 30 copë
- **Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

## 8. Shkrim në Plexiglass Transparent me LED Neon

- Shkrimi informues në plexiglass transparent me ndriçim LED Neon.
- **Përmasat:** 150x60 cm
- **Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

## 9. Mobilje për Instalacionet

- Mobilje për vendosjen e ekspozitave dhe instalacioneve brenda muzeut.
- **Sasia:** 2 copë
- **Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

## 15. Aktivitete për fëmijë (3 ditë )

- Maskota, face paint me ngjyra hypoallergenic

## 16. Mbulimi me Shërbim Fotografie për 3 Dite

Përmbushja e kërkesës për mbulim të plotë me shërbim fotografie gjatë festivalit për arkiv dhe postime në web dhe portale:

### 1. Fotografi për Arkiv

- Përdorim të kamerave profesionale për kapjen e momentëve kryesorë të festivalit për qëllime arkivimi.

### 2. Fotografi për Postime në Ë eb dhe Portale

- Caktimi i seancave fotografike për krijimin e materialeve vizuale të nevojshme për postime në ë eb dhe portale mediatike.

**Sasia:** 3 (tre) ditë mbulim fotografik për ngjarjet e festivalit.

## 16. Mbulim me shërbimin PR 1 (një) shërbim i plotë

Shërbime të plota për menaxhimin e marrëdhënieve me publikun (PR) për Festivalin e Peshkut:

### 1. Menaxhimi i Marrëdhënieve me Mediat

- Komunikimi me mediat lokale dhe kombëtare për të siguruar mbulim të duhur të ngjarjes dhe aktivitetet e festivalit.

### 2. Komunikimi me Influencuesit dhe Personalitete të Larta

- Bashkëpunim me influencues dhe personalitete të njohur për të rritur ekspozimin dhe përfshirjen e festivalit.

### 3. Përgatitja e Lajmeve dhe Njoftimeve për Shtyp

Hartimi i komunikatave dhe njoftimeve për shtyp për të shpërndarë informacionin më të fundit rreth festivalit dhe aktiviteteteve përkatëse

## 17. Struktura hyrëse e eventit

- Strukturë: Metal truss / tub hekuri
- Banner: PVC 510 gr/m<sup>2</sup>
- Printim: UV print
- Përmasa: sipas projektit (approx 4–6 m gjerësi)
- Sasia : 1 copë
- **Shërbimi:** Dizajnim, prodhim, montim

## 18. Skenografia

Pergatitje rendera 3D, zberthim teknik, prodhim materialesh dhe realizim i skenografise per permasa 15 m gjeresi dhe 10 m lartesi

- Nuk perfshihet Stage, Audio, Led, Ndricim skenik.

- Materiale: MDF, print vinyl, struktura metalike
- Rendera: 3D (SketchUp / Blender / 3ds Max)
- Rezolucion render: min 1920x1080
- Design, Konceptim dhe Prodhimi i skenografisë , zberthim teknik, prodhim materialesh dhe realizim i skenografise: (- Nuk perfshihet Stage, Audio, Led, Ndricim skenik.)

*Projekti i skenografisë përfshin elemente dekorative tridimensionale, panele LED për paraqitje të përmbajtjeve vizuale dinamike, si dhe sisteme ndriçimi skenik profesional të programueshëm, të integruara në mënyrë të harmonizuar me strukturën dhe arkitekturën e skenës. Materialet e përdorura janë të certifikuara për përdorim të jashtëm dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike, duke garantuar qëndrueshmëri, siguri dhe performancë të përshtatshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit.*

*Në kuadër të paraqitjes së projektit, kërkohet dorëzimi i dokumentacionit teknik dhe vizual përkatës, i cili përfshin planimetrinë e përgjithshme të skenografisë, prerjet dhe fasadat teknike, vizatimet e detajuara të elementeve kryesore, rendera 3D fotorealitike nga kënde të ndryshme (ditë/natë), si dhe skemat funksionale të ndriçimit dhe vendosjes së pajisjeve audio-vizuale. Ky dokumentacion shërben për garantimin e qartësisë së zgjidhjes së propozuar dhe verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor. Para fillimit të prodhimit, skenografia e propozuar duhet të paraqitet për miratim pranë autoritetit nënkontraktor, dhe zbatimi i saj mund të nisë vetëm pas marrjes së aprovimit përfundimtar nga ky autoritet.*

#### 19. Shërbime elektrike dhe instalime për eventin

Lidhje me energji elektrike e zonave të ndryshme të eventit, nuk përfshihet lidhja me burimin kryesor të OSHE

- Kabllo: Outdoor IP65 500 m
- Shpërndarje: panel elektrik + shpërndarës 3 copë
- Siguri: grounding + mbrojtje nga lagështia 1 copë
- Ndricimit te zonave te eventit (Nuk perfshihet lidhja me burimin kryesor te OSHEE)

#### 20. Skena

Pershkrimi teknik i elementeve perberës të skenes si me poshte:

NR	Pershkrimi	Njesia Matese	Cmimi njesi	Sasia	Total pa TVSH
1	Boks pasiv me mundesi per tu varur (Line Array)	cope		12	
2	Amplifikator fuqie per foni te varur sistem Line Array)	cope		6	
3	Boks aktiv per muzike dhe monitor skene	cope		4	
4	Boks aktiv me frekuence te ulet	cope			
5	Boks pasiv me frekuence te ulet me mundesi per tu varur (Line Array)	cope		6	
6	Mikrofon valor	cope		4	
7	Mikrofon instrumenti	cope		6	
8	Mikrofon vokali me kabell	cope		6	
9	Set mikrofonash per bateri	Set		1	
10	Mikrofon per prezantues	cope		4	

11	Shperndares sinjali audio/spliter	cope		4	
12	Mikser Audio me 64 kanale	cope		1	
13	Set pajisjesh per DJ (pult dj dhe CD0player)	Set		1	
14	Ekran led me rezolucion jo me shume se 3.9 mm (per ambient te jashtem)permasa paneli 50cmX100cm	m2		100	
15	Video procesor	cope		1	
16	Video Server	cope		1	
17	Personal Computer Laptop	cope		1	
18	Projektor 20 000 Lumens	cope		2	
19	Projektor Ndricimi Profile me Led + Lente	cope		6	
20	Ndricules Fresnel me Led me 6 ngjyra, i 260 Ë	cope		0	
21	Ndricules LED Arkitektural: 18X10Ë RGBË APFC me fuqi te larte dhe lente superiore optikale me sistem 6 ngjyresh. Kontroll individual I pixelave LED, lente te ndryshueshme 25° (on board), 45° (optional), Silent operation and HD dimming system, Protocol USITT DMX 512 (+/0 5% tolerance ne te gjithe parametrat teknike)	cope		24	
22	Ndricules LED 100 cm 12/bara led LED+B50:B67+B50:B54 me efikasitet të lartë 12x8Ë RGBË / FC	cope		12	
23	Ndricules me koke te rrotullueshme Led Ë ash Me Zmadhim elektronik 14 ° 070 °	cope		12	
24	Moving Head Spote LED:Lëvizëse e vlerësuar me IP 420 Ë me zmadhim dhe përzierje ngjyrash LED lëvizës i fuqishëm dhe fleksibël :IP65 e vlerësuar për ngjarje në natyrë dhe instalime të përkohshme.LED me fuqi të lartë 420 Ë me CT 7.000 K dhe zmadhim linear 5° 0 50°.(+/0 5% tolerance ne te gjithe parametrat teknike)	cope		16	
25	Strobe me Led 1000 Ë me Burim drite LED Këndi i reze 140 grade	cope		12	
26	Blinder me burim LED	cope		12	

27	Folloë Spot, Burimi: 2500 Ë HMI Mbështetje magnetike 0 e nxehtë, zoom 4,5 ° deri në 8 °	cope			
28	Tymuse skenike	cope		2	
29	Splitter DMX 0 ndarës i sinjalit	cope		6	
30	Mikser regji Ndricimi 45 fader te motorrizuar , dhe master i automatizuar me ekran te gjerë 15.6 "	cope		1	
31	Skela hekuri 6m te Larte me 6m te gjere dhe 2m te thelle qe sherbejne per mbajtjen e ndricimit	cope		12	
32	Motorr elektrik/vinca per peshe deri ne 1T	cope		64	
33	Spliter sinjali per robotet e ndricimit	cope		6	
34	kanalina gome per mbulimin e kabujve	cope		20	
35	Panel Kontrolli I energjise elektrike 32 amp	cope		4	
36	Panel Kontrolli I energjise elektrike 16 amp	cope		4	
37	Panel kontrolli I energjise elektrike 400 amp	cope		0	
38	Panel Kontrolli I energjise elektrike 125 amp	cope		1	
39	Gjenerator 350 KË	cope		1	
40	Karrige	cope		200	
41	Tavolina	cope		50	
46	Strukture skenike	m2		120	
47	Vinca manual 5m/ 150 kg	cope		2	
48	Podium me lartesi te ndryshem	m2		120	

1. **Boks pasiv me mundësi për t'u varur (sistem Line Array)**

Sistem altoparlanti pasiv për konfigurim line array, i përshtatshëm për përdorim në evente outdoor dhe indoor. Të jetë i projektuar për instalim në kolona vertikale, me dispersion horizontale të kontrolluar dhe performancë të qëndrueshme në mbulimin e audiencës. Të jetë i pajisur me drejtues frekuencash të ulëta me diametër jo më pak se 8 inç ose ekuivalent dhe me drejtues frekuencash të larta jo më pak se 1 inç. Të ketë elementë të integruar ose të dedikuar për varje të sigurt dhe përdorim profesional.

2. **Amplifikator fuqie për foni të varur sistem Line Array**

Amplifikator profesional fuqie me të paktën dy kanale, i përshtatshëm për përdorim me sisteme line array dhe altoparlantë profesionale. Të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme me ngarkesa nga 4 deri në 16 Ohm. Të ketë fuqi të përshtatshme për drejtimin e sistemeve profesionale audio, me qark mbrojtës kundër mbinxehjes, mbingarkesës dhe qarkut të shkurtër. Të ketë procesim të integruar ose të jashtëm për menaxhimin e altoparlantëve dhe konfigurimeve të sistemit.

- 
3. **Boks aktiv për muzikë dhe monitor skene**  
Sistem monitorimi skene ose altoparlant për përdorim skenik profesional, i përshtatshëm si monitor floor ose si sistem full range sipas nevojës. Fuqia të jetë jo më pak se 400 W RMS dhe niveli maksimal i presionit zanor jo më pak se 130 dB SPL. Të ketë dispersion të kontrolluar, kabinet të fortë për përdorim intensiv, mundësi vendosjeje horizontale ose vertikale dhe mbrojtje të përparme metalike.
  4. **Boks aktiv me frekuencë të ulët**  
Subë oofer aktiv profesional për riprodhim të frekuencave të ulëta, i përshtatshëm për evente live, koncerte dhe aktivitete outdoor. Të jetë i pajisur me drejtues jo më pak se 18 inç. Niveli maksimal i presionit zanor të jetë jo më pak se 135 dB SPL. Të ketë kabinet të fortë, elemente për transport si doreza dhe/ose rrota, si dhe mundësi integrimi me sisteme të tjera audio profesionale.
  5. **Boks pasiv me frekuencë të ulët me mundësi për t'u varur (Line Array)**  
Subë oofer pasiv profesional për sisteme line array, i pajisur me të paktën dy drejtues me diametër jo më pak se 18 inç. Të jetë i përshtatshëm për konfigurime omni ose kardioide dhe për përdorim në konfigurime të grumbulluara në tokë ose të varura. Kabineti të jetë i fortë dhe i përshtatshëm për përdorim touring.
  6. **Mikrofon valor**  
Sistem mikrofonik ë ireless dixhital për përdorim profesional në fjalime dhe performanca. Të përfshijë transmetuesin dhe marrësin/bazën përkatëse. Të ketë enkriptim të sinjalit ose nivel të lartë sigurie në transmetim. Të mbulojë frekuencë pune të përshtatshme për audio profesionale, jo më pak se 20 Hz deri në 20 kHz. Të ketë dalje analoge dhe/ose dixhitale dhe të jetë i përshtatshëm për përdorim në ambiente profesionale.
  7. **Mikrofon instrumenti**  
Mikrofon profesional për instrumente, veçanërisht për instrumente frymore ose aplikime të ngjashme, me sistem kapjeje ose montimi të përshtatshëm. Të jetë tip kondensator dhe të mbështesë furnizim standard phantom poë er. Frekuenca e punës të jetë jo më pak se 60 Hz deri në 20 kHz.
  8. **Mikrofon vokali me kabëll**  
Mikrofon dinamik profesional për vokal live, me karakteristikë polare kardioide ose superkardioide. Frekuenca e punës të jetë jo më pak se 50 Hz deri në 16 kHz. Të jetë i përshtatshëm për përdorim nga këngëtarë ose folës në skenë dhe të ketë ndërtim të fortë për përdorim intensiv.
  9. **Set mikrofonash për bateri**  
Set profesional mikrofonash për kapjen e një seti baterie, i përbërë nga jo më pak se 5 deri në 7 mikrofone. Seti të përfshijë mikrofonë të përshtatshëm për bas drum, snare/tom, overhead dhe aplikime të ngjashme. Të jetë i përshtatshëm për përdorim live dhe/ose regjistrim.
  10. **Mikrofon për prezantues**  
Sistem mikrofonik headset ose earset për prezantues, i përshtatshëm për përdorim hands-free. Të përfshijë mikrofonin, transmetuesin bodypack dhe marrësin përkatës. Të ketë ndërtim ergonomik, peshë të ulët dhe ngjyrë neutrale ose të përshtatshme për përdorim skenik apo televiziv.
  11. **Shpërndarës sinjali audio / Split**  
Pajisje për shpërndarje ose ndarje sinjali audio profesional me shumë kanale, e përshtatshme për përdorim live dhe instalime të përkohshme. Të ketë hyrje dhe dalje standarde profesionale, si dhe mundësi furnizimi phantom për kanalet që e kërkojnë. Të jetë e përshtatshme për integrim me sisteme miksimi ose stagebox.
  12. **Mikser audio me 64 kanale**  
Mikser audio dixhital profesional me jo më pak se 64 hyrje mono ose ekuivalente funksionale. Të ketë jo më pak se 32 dalje ose konfigurim ekuivalent. Të mundësojë regjistrim multi-track, procesim të avancuar në hyrje dhe dalje, memorim skenash dhe funksione të përshtatshme për përdorim live profesional.
  13. **Set pajisjesh për DJ**  
Set profesional për DJ performance, i përbërë nga player dhe mixer ose zgjidhje ekuivalente. Të

- 
- jetë i përshtatshëm për përdorim live, me dalje audio profesionale, funksione miksimit dhe kontrolli të përshtatshme për performancë.
14. **Ekrane LED me rezolucion jo më shumë se 3.9 mm (për ambient të jashtëm)**  
Ekran LED modular për përdorim outdoor, me pixel pitch jo më të madh se 3.9 mm. Të jetë i përshtatshëm për riprodhim videosh, grafikash dhe imazhesh në cilësi të lartë. Panelet të jenë modulare dhe të përshtatshme për montim në struktura standarde profesionale. Të kenë ndriçim të lartë për përdorim në ambient të jashtëm dhe mbrojtje të përshtatshme ndaj kushteve atmosferike.
  15. **Videoprosesor**  
Procesor video për kontrollin dhe menaxhimin e ekraneve LED. Të ketë hyrje standarde video si HDMI, DVI, VGA, USB ose ekuivalente sipas teknologjive bashkëkohore. Të jetë i përshtatshëm për përdorim profesional në evente dhe për menaxhim të sinjaleve vizuale në kohë reale.
  16. **Video server**  
Media server profesional për playback video, me mundësi menaxhimi të shumë shtresave vizuale. Të ketë hyrje dhe dalje video të llojeve standarde profesionale ose ekuivalente dhe kapacitet të përshtatshëm për përdorim në evente live, skenografi digjitale dhe produksione vizuale.
  17. **Personal Computer Laptop**  
Kompjuter portativ për përdorim profesional në audio, video, ndriçim ose menaxhim eventesh. Të ketë performancë të përshtatshme për përdorimin e programeve profesionale të kontrollit, playback, konfigurimit ose monitorimit teknik.
  18. **Video projektor 20,000 lumen**  
Projektor profesional me intensitet drite jo më pak se 20,000 lumen, i përshtatshëm për evente, konferenca, projektme të mëdha ose skenografi vizuale. Të ketë rezolucion jo më pak se Full HD dhe hyrje standarde video si HDMI, DVI ose ekuivalente.
  19. **Kamera me rezolucion Full HD ose 4K**  
Kamerë profesionale për filmim dhe regjistrim në rezolucion Full HD ose 4K. Të ketë mundësi regjistrimi audio, ruajtje në media të përshtatshme dhe dalje SDI ose HDMI ose ekuivalente për transmetim ose projektion të drejtpërdrejtë.
  20. **Projektor Ndriçimi Profile me LED + lente**  
Ndriçues profesional tip profile me burim LED, i përshtatshëm për teatro, konferenca, evente dhe aplikime skenike. Të ofrojë riprodhim të mirë të ngjyrave, fokus të rregullueshëm, lente ose optikë të përshtatshme sipas përdorimit dhe kontroll profesional të parametrave të dritës.
  21. **Ndriçues Fresnel me LED**  
Ndriçues profesional tip Fresnel me burim LED, me temperaturë ngjyre të rregullueshme ose ekuivalente funksionale, me zoom të rregullueshëm dhe ndriçim të njëtrajtshëm. Të jetë i përshtatshëm për teatër, konferenca, televizion ose evente live.
  22. **Ndriçues LED arkitekturale**  
Ndriçues LED për aplikime arkitekturale ose dekorative, me shumë ngjyra dhe kontroll profesional. Të jetë i përshtatshëm për ndriçim fasadash, strukturash, elementësh skenikë ose hapësirash eventesh, me kontroll individual ose në grup dhe me përdorim indoor/outdoor sipas nevojës.
  23. **Ndriçues LED 100 cm**  
Ndriçues linear LED me gjatësi afërsisht 100 cm, me përzierje ngjyrash RGB ose RGBE ose ekuivalent dhe me mundësi kontrolli në seksione ose pikselë. Të jetë i përshtatshëm për efekte dinamike dhe përdorim në skenë ose instalime vizuale.
  24. **Moving Head Spot LED**  
